



## Permbledhje joteknike e aktiviteteve

### “Industrite energjitike”

*ID. 1.7 Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave.*



**Subjekti:** “Gaz Power AL” sh.a.

**Hartoi:** “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

**Administrator:** Shkelzen MADANI



Tirane, 2022



## **PERMBAJTJA**

- ✚ Hyrje**
- ✚ Baza ligjore**
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit**
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se**

- 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
- 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
- 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
- 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
- 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobeseve ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit ”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisit tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



## 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti: "Gaz Power AL" sh.a., eshte regjistruar prane QKB me Nr. NIPT L21409504T me date 09/02/2012 kryen aktivitetin "Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave" me vendodhje Rruga Kuvendi Francekian, Porto Romano, Durres me nje siperfaqe totale prej 4342 m<sup>2</sup> dhe siperfaqe te impiantit 2450 m<sup>2</sup>.



### Koordinatat ne sistemin KRGJSH

X	Y
452182.38	4581578.50
452233.06	4581603.98
452275.90	4581524.18
452225.50	4581500.10

Gaz i lengezueshem ne temperature ambienti me tension maksimal avujsh prej 18 bar ne 50°C, e dendesi jo me te vogel se 440 kg/m<sup>3</sup> ne 50°C, i perbere kryesisht nga hidrokarbure parafinike dhe olefinike me 3 apo 4 atome karboni.

Volumi maksimal i gazit te lengezuar ne rezervuar duhet te jete i tille, qe te mos kalohet 85% e volumit nga faza e lenget e tij. Kjo kushtezohet nga zgjerimi i gazit ne kushtet e rritjes se temperatures, e cila nuk duhet te kaloje 50°C gjate punes. Zakonisht sasia maksimale, qe ze faza e lenget ne rezervuar eshte per propanin 82% dhe per butanin ose perzierjet 85%.



Rezervuaret duhet te jene mbeshtetje te qendrueshme prej betoni ose murature ose me konstruksione celiku. Keto mbeshtetese duhet te jene rezistente ndaj zjarrit te pakten per 2 ore. Mbeshtetese te jene te tilla, qe te lejojne zhvendosjet aksiale te rezervuareve, per shkak te ndryshimit te temperatures. Mbeshtetjet e rezervuareve duhet te konstruktohen te tilla, qe te mos lejojne grumbullime uji dhe te shkarkojne ate. Rezervuaret duhet te jene ancorim sa me te sigurt e lartesi baze te mjaftueshme, qe te ruajne stabilitet nga ngarkesa te jashtezakonshme ose ne rast permbytje, per tu mbrojtur nga korrozioni, rezervuaret dhe mbeshtetese duhet te lyhen me boje.

Ne amjentet e shoqerise do te depozitohet nje sasi gazi prej 660 m<sup>3</sup>, e cila do te shitet me shumice dhe pakice ne objektet industriale dhe sistemet e ngrohjes me kaldaje ne industrine prodhuese e perpunuese te rajonit. Transporti i karburantit dote kryhet me autocisterna me kapacitet te madh per furnizimin dhe me autocisterna me kapacitet me te ulet per shitjen, kjo ne varesi te kerkesave te klientit. Hidrokarburet qe do te depozitohen jane nenprodukte te naftes dhe me konkretisht lende djegese si gaznatyror. Objekti ne teresi eshte i pajisur me sistemin zjarrfikese dhe me sistemin e perballimit te emergjencave.

Impianti do jete i pajisur me nje njet hidrantesh ON 70, te shperndare ne menyre qe te mundesojne nderhyrjen mbi cdo element te rrezikshem te impiantit.

Impianti do pajiset me sinjalistiken perkatese, e cila perfshin sinjalet paralajmeruese, ndaluese dhe te rrezikut, konform dispozitave ne fuqi per ceshtjet ne fjale, si edhe sinjalistikat pershkruese te procedurave te emergjences dhe harten e mjeteve kunder zjarrit. Te gjitha sistemet e kontrollit do te jene te lidhura me njesine e salles operative e cila ne menyre automatike do te aktivizojte masat paraprake, nderprerjen e problemeve pergjate operacioneve normale.

## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **Pozita Gjeografike**

Durrësi është qyteti i dytë më i populluar i Republikës së Shqipërisë dhe selia e Qarkut Durrës dhe Bashkisë Durrës. Ndodhet në një fushë të rrafshët përgjatë bregut shqiptar të detit Adriatik midis grykëderdhjeve të Erzenit dhe Ishëm në cepin juglindor të detit Adriatik. Klima e Durrësit ndikohet thellësisht nga klima sezonale mesdhetare.

### **Klima**



Sipas klasifikimit të klimës Köppen, Durrësi klasifikohet nën periferinë e zonës së nxehtë klimatike mesdhetare të verës (Csa) me një temperaturë mesatare vjetore prej 15,9 °C (60,6 °F). Klima e saj ndikohet nga afërsia me detin Adriatik në Detin Mesdhe dhe kodrat në Ultësirën Perëndimore në brendësi. Vera është kryesisht e nxehtë dhe e thatë, dimri relativisht i butë, dhe vjeshta dhe pranvera kryesisht të qëndrueshme, për sa i përket reshjeve dhe temperaturave. Temperatura mesatare mujore varion nga 7,5 °C (45,5 °F) në dimër deri në 23,8 °C (74,8 °F) në verë. Temperatura më e lartë prej 39 °C (102 °F) u regjistrua më 14 gusht 1957. Temperatura më e ulët prej -6.2 °C (20.8 °F) u regjistrua më 26 janar 1954. Durrësi merr pjesën më të madhe të reshjeve në muajt e dimrit dhe më pak në muajt e verës.



Reshjet mesatare vjetore variojnë midis 1,000 milimetra (39 in) dhe 1,273 milimetra (50,1 in).

Durrës - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Temp. Maks. (°C)	11	12	15	18	23	28	30	30	26	22	17	12	Ø 20,3
Temp. Mini. (°C)	4	5	8	11	15	19	21	21	17	14	10	6	Ø 12,6
Reshje (mm)	91	103	99	83	63	50	31	43	118	80	146	140	Σ 1.047



## Relievi

Territori i qytetit të Durrësit bën pjesë në ultësirën Adriatike (ultësira perëndimore). Relievi ka moshe të re sepse është formuar shumë vone. Rol të rëndësishëm në formimin e relievit kanë pasur dhe kanë: klima mesdhetare, veprimtaria e ujrave rrjedhës, agjentet atmosferike dhe vetë njeriu. Relievi i Durrësit ka keto tipare:

1. Ka karakter fushor.
2. Relievi është gershetimi i formave të rrafshta me ato kodrinore.
3. Relievi është eroziv, që do të thotë grryhet.
4. Një pjesë e mirë e relievit të Durrësit e zë relievi bregdetar. Në relievin bregdetar ndërthuren kepe dhe gjire. Te tilla janë: kepi i Bisht Palles, kepi i Rodonit kepi i Lagjit, gjiri i Durrësit, gjiri i Lalzit, gjiri i Rodonit etj.

Në qytetin e Durrësit dallohen disa tipe relievesh: bregdetar, fushor, kodrinor, lumor, kodrinor.

- Relievi i Durrësit shtrihet si rrip i ngushtë përgjatë vijës bregdetare, që dallohen për alternimin e plazheve ranore me kepe shkembore.
- Relievi lumor përbehet nga: luginat e lumenjve Erzen dhe Ishem. Format më të përhapura të lumenjve janë luginat lumore.
- Relievi i ulet përfaqësohet nga fushat: e Durrësit, Shijakut e Spitalles.
- Keneta e Durrësit ndodhet në ultësirën bregdetare perëndimore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 3600 ha.



## Ekonomia

Durrësi është një lidhje e rëndësishme me Evropën Perëndimore për shkak të portit të tij dhe afërsisë me qytetet portuale italiane, veçanërisht Barin, në të cilin udhëtojnë tragetet çdo ditë. Përveç kantierit detar, ai posedon gjithashtu një kantier detar dhe industri të rëndësishme prodhuese, veçanërisht prodhimin e produkteve të lëkurës, plastikës dhe duhanit.

Shtirirja bregdetare jugore e Golemit është e njohur për turizmin e saj tradicional masiv të plazhit që ka përjetuar zhvillim të pakontrolluar urban. Plazhet e qytetit janë gjithashtu një destinacion popullor për shumë turistë të huaj dhe vendas. Në vitin 2012, sistemet e reja të kanalizimeve të ujit po instalohen për të eliminuar ndotjen e ujit të detit. Në të kundërt, pjesa veriore bregdetare e Gjirit të Lalzit është kryesisht e paprishur dhe e vendosur të bëhet një destinacion elitist turistik, pasi një sërë resorte plazhi po ndërtohen që nga viti 2009. Rrethet fqinje janë të njohura për prodhimin e verës së mirë dhe një shumëllojshmëri produktesh ushqimore.

Sipas Bankës Botërore, Durrësi ka bërë hapa të rëndësishëm për fillimin e një biznesi në vitin 2016. Durrësi renditet i nënta ndër 22 qytete në Evropën Juglindore përpara kryeqytetit Tiranë, Beograd, Serbi dhe Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë.

### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të



kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitakisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

## **NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS**

- **Ndikimet ne cilesine e ajrit**

Shkarkime ne ajer do te kemi vetem nga levizjet e mjeteve te cilat do te vijne per te kryer sherbimet ne ambientet e instalimit. Keto shkarkime do te jene minimale dhe nen norme. Shkarkime si pasoje e zhvillimit te aktivitetit, gjithashtu edhe shkarkime te rendesishme me karakter ndotes nuk do te kemi.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat qe krijohen jane si rezultat i levizjes se makinave te transportit te cilat do te jene te kufizuara ne kohe dhe nen normat e lejuara, zhurma te tjera nuk do te kete gjate zhvillimit te aktivitetit.

- **Ndikimet mbi popullsine**

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsine perreth, pervecse zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjelle punesimin e disa banoreve perreth duke kontribuar sadopak ne rritjen e mireqenies ne zone perreth.

## **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V, madje jane vendosur koshat qe keto mbetje ti ndaje sipas karakterit te tyre.
- Automjetet e transportit qarkullojne me shpejtesi te ulet te menyre qe te mos krijohen vibrime.
- Ne pjesen e mbetur te siperfaqes se lire operatori ka mbjelle peme per te krijuar nje pamje vizuale te bukur por edhe per te ulur ndikimin ne mjedis dhe pse nga te gjitha gjykimet e bera ato jane ne nivele te ulta dhe totalisht te pranueshme.
- Operatori eshte i kujdeshem ne mirembajtjen e rruges hyrese te subjektit
- Masat per mbrojtjen kunder zjarrit te cilat jane shume te rendesishme dhe jane si me poshte:
  - Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
  - Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuaresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces
  - Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
  - Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.

- **Mbrojtja nga aksidentet dhe rregullat ne vendin e punes**

**Rregullat e vendit te punes te operatorit te mbushjes se bombolave.**





1. Perpara fillimit te punes kontrollohet inventari i mjeteve mbrojtese nga zjarri dhe gjendjen e tyre teknike (manometri i presionit te fikses duhet te qendroje fushes se gjelber). Nuk duhet te filloje puna pa eliminuar mangesite e konstatuara. Nuk duhet lejuar material hekuri dhe material te tjera te panevojshme ne platformen e mbushjes se bombolave.
2. Takohet pompa dhe kontrollohet sektori i punes per rrjedhje gazi nga valvolat apo pistoletat. Lajmerohet personeli teknik per rrjedhjet dhe pas riparimit vazhdohet puna. me anen e ventilin by-pass rregullohet presioni n elinje 9-10bar.
3. Kontrollohet data e kolaudimit te bomboles dhe vendoset bombolen ne peshore;  
*Ndalohet mbushja e bombolave jashte afatit te kolaudimit, me defekte ne trup si shtypje, gervishtje te thella, ndryshk, keputje te mbrojtetit te ventilin, ventilin te bllokuar, kur nuk lexohet tara, viti i prodhimit, kur nuk ka stapen e firmes se licencuar per kolaudim bombolash gazi.*
4. Kontrollohen nese bombola ka presion mbetes duek hapur pak ventilin. Ne rast se bombola nuk nxjerr gaz. Te procedohet ne nxjerrjen e ajrit pas mbushjes se saj. Kontrollohet nese bombola qe do te mbushet ka rrjedhie gazi nepermjet eres, fershellimes se gazit, ose kondesimit ose ngrirjes se avujve te ujit, Mos te perdoret per kontroll flake e zhveshur ose shkendije.
5. Vendos pistoleten ne bombol dhe kontrollohet pesha e saj bosh, vendoset rregjistrin e peshores per peshen plot. Neqoftese pesha bosh e bomboles eshte me e madhe se tara, atehere kjo do te thote se bombola ka leng, keshtu qe rregjistri do te rregjistrohet do te vendoset sa tara plus peshen nominale qe duhet te mbaje bombola.
6. Hap ventilin e bomboles dhe kontrollohet me sy mbushja derisa shigjeta e peshores te barazohet me shigjeten e regjistrin. *Ne cdo rast ndalohet rreptesisht mbushja mbi kapacitetin e bomboles. Bombolat e mbushura me teper duhet te shkarkohen.*
7. Mbyll ventilin e bomboles, largo pistoleten, zhvendos bombolen nga peshorja, kontrollo ventilin per rrjedhje, vendos tapen plastike duke perdorur vetem cekis druri ose gome, vendos etiketen e qendres se mbushjes, sistemo bombolen ne sektorin e posacem per bombolat plot. *Ndalohet rreptesisht dorezimi per shitje o bombolave me rrjedhje gazi. Bombolat me rrjedhie gazi sistemohen ne nje vend te posacem per zbrasje dhe riparim.*
8. Ne platformen e mbushjes se bombolave sistemo bombolat bosh dhe plot sipas sektoreve te percaktuar me shkrim ne dysheme.

#### **Rregullat e vendit te punes te ngarkimit dhe shkarkimit te autocisternave.**

1. Shkarkimi dhe ngarkimi i autocisternave eshte procesi i transferimit te gazit te lenget nga nje ene ne tjetren nen presion. Ky transferim kryhet me ndihmen e pompave ose kompresoreve dhe sistemit te tubacioneve te pajisur me armaturat perkatese
2. Shkarkimi/ ngarkimi i autocisternes behet vetem ne vendin e caktuar. para futjes ne vendin e ngarkim/ shkarkimit kontrollo autocisternen qe te jete e pajisur me aparatet e nevojshme si nivel tregues ose tregues spiun i nivelit maksimal, manometer i presionit te fazes gaz, fikse zjarri, flakeshuarse dshe system vetndezje te rregullt. Gjithashtu autocisterna duhet te jete e pajisur me lejen e inspektoriatit te eneve nen presion. *Ndalohet futja per shkarkim/ngarkimin e mjeteve qe kane mangesite e mesiperme*



3. Parkohet autocisterna ne vendin e caktuar, nen dushin ftohes, ngri frenat e dores, fik motorin, vendos tako tek gomat e mjetit, realizo lidhjen e kabllit te tokezimit te autocisternes me sistemin e pergjithshemte tokezimit , lidh tubat e fazes gaz dhe fazes leng me ventilat perkates te autocisternes, bej proven e hermeticitetit te lidhjes, hap menjehere valvolat e te dy fazave te rezervuarit ku do te transferohet lengu, hap gradualisht ventilin e fazes se gazte dhe po keshtu ventilin e fazes se lenget te autocisternes. Ne rast se nga hapja e shpejte verpojne bllokuesit automatik te autocisternes, mbyll te dy valvolat e autocisternes dhe perserit hapjen e tyre graduale pas disa minutash.
4. Hap ventilin e thithjes se pompes, hap by-passin me dore, tako pompen, mbyll by-passin me dore, hap gradualisht ventilin e dergimit te lengut ne rezervuar, Kontrolllo presionin e pompes dhe punen e saj. ne rast s ekonstaton rrjedhej n epermistopin e pompes apo zhurma te pazakonta stako menjehere pompen.
5. Kur transferimi behet nga rezervuari ne autocisterne vendos treguesitn mekanik te nivelit te autocisternes ne nivelin e caktuar, *mos lejo ne asnje rast qe autocisterna te mbushet mbi 85% te volumit ne dimes dhe 75 % te volumit ne vere.*
6. Pas perfundimit te ngarkimit te autocisternes mbyll ventilat e jashtem te autocisternes, mbyll ventilat e brendshem te autocisternes, stako pompen, cmonto flanaxhat, kontrollo per rrjedhje ventilat e autocisternes, vendos flanaxhat qorre. *mos lejo ne menyre kategorike qe autocisterna te levise pa vendso flanaxhat qorre, si ne rastin kur autocisterna eshte e mbushur me gaz leng ashtu dhe ne rastin kur auticisterna ka vetem nje faze te gazte. Flanaxhat duhet detyrimisht te montohen me kater ose me shume bullona.*
7. Kur presioni ne autocisterne rritet mbi 12 bar per shkak te temperatures se larte te ambientit tako pompen e sistemit zjarrfikesit dhe hap dushin ftohes me uje.
8. Kur transferohet i gazit ne fazen leng nga autocisterna ne rezervuar kryhen te njejtat veprime si me lart duke bere kujdes qe tem so lejohet mbimbushja e rezervuareve stacionare mbi kufirin 85 % ne dimer dhe 80% ne vere.

### **Rregullat per vizitoret ne qendren e depozitimit dhe mbushjes se bombolave.**

#### **Kujdes!**

- **Rrezik zjarri**
  - **Rrezik shperthimi**
  - **Rrezik asfiksimi**
1. Te gjithë personat dhe automjetet qe hyjne ne kete qender depozitimi dhe mbushje bombolash jane te detyruar te zbatojne kete rregullore.
  2. Ndalohet perdorimi i cigares dhe cfaredo lloj flake te hapur ne qender.
  3. Ndalohet perdorimi i aparaturave celurare, fotografike dhe aparaturave te ngjashem ne territorin e qendres.
  4. Automjetet te jene te pajisura me flakeshuarse ne gypin e gazrave, me system te rregullut vetendezje dhe te pajisur me shuarse zjarri, ndalohen mjetet me kandle me hedhje te centilit dhe me rrjedhje te karburanti.
  5. Ndalohet hyrja e te miturve ne qender.
  6. Ndalohet qarkullimi i personave dhe mjeteve te pa autorizuar ne zonen me qarkullim te kufizuar te qendres.